

**Vendim nr. 176 datë 26.07.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 26.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (Sh) 2024 të Regjistrat Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** SHOQËRIA “BEADINI” SH.P.K., përfaqësuar nga avokat Sokol Gjini, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-55, datë 19.01.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 16, 18, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 50, pika 4, 71, pika 1 dhe 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja, shoqëria “Beadini” sh.p.k., me seli në Shëngjin, Lezhë, ka për objekt veprimtarie edhe atë në fushën e shitblerjes së pasurive të paluajtshme. Ajo ka për ortak të vetëm dhe administrator shtetasin A.B. Ky i fundit, në datën 10.09.2013, ka lëshuar një prokurë të përgjithshme me të cilën ka emëruar si përfaqësuese shtetasen M.M., duke i dhënë asaj, ndër të tjera, të drejtën që, në emër dhe për llogarinë e tij si individ dhe të shoqërisë kërkuese, të blinte pasuri të paluajtshme në Shqipëri duke e autorizuar të nënshkruante aktet noteriale të shitblerjes, t’i regjistronte ato në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të tërhiqte dokumentet e pronësisë për pasuritë e blera. Me anë të kësaj prokure, gjatë viteve 2013 - 2014, shtetasja M.M. ka blerë disa pasuri të paluajtshme për llogari të kërkueses, ndërsa shtetasi A.B. dhe familjarë të tij i kanë transferuar ose dorëzuar në dorë kësaj shtetaseje vlera monetare për të bërë pagesat e blerjeve.

2. Në datën 26.02.2015 shtetasi A.B., në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të kërkueses, ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasës M.M. dhe bashkëshortit të saj F.M., të cilët, sipas kallëzuesit, kanë kryer veprën penale të mashtrimit me pasoja të rënda, ndërsa disa nga pasuritë e blera nuk kanë kaluar në pronësi të kërkueses, pavarësisht se e kallëzuara M.M. ka marrë vlerën e çmimit nëpërmjet dokumenteve fiktive të prezantuara prej saj. Mbi këtë kallëzim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar një procedim penal kundër shtetasve M.M. dhe F.M., të cilët në vijim i ka akuzuar për veprën penale “Mashtrimi”, në bashkëpunim dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143, paragrafi 2, i Kodit Penal (KP), në rrethanat kur në 6 raste, duke përdorur gënjeshtrenë dhe shpërdoruar besimin e të dëmtuarit, kishin arritur të përfitonin shuma parash për blerje të disa pasurive, të cilat në fakt nuk janë blerë. Ndaj këtyre shtetasve është zbatuar masa e sigurimit “Arresti në burg” sipas vendimeve gjyqësore të datës 02.04.2016, ndërsa në vijim, për F.M. është zëvendësuar masa e sigurimit, fillimisht me atë të “Arresti në shtëpi” dhe, më pas, me atë të “Detyrimit për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”. Në përfundim të hetimeve paraprahe çështja është dërguar për gjykim.

3. Në përfundim të gjykimit të çështjes, që është zhvilluar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 111, datë 30.03.2017, ka deklaruar fajtorë të pandehurit M.M. dhe F.M. për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, në bashkëpunim dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143, paragrafi 2, i KP-së, duke dënuar M.M. me 12 vjet burgim dhe F.M. me 10 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), gjykata ka aplikuar uljen e dënimit me 1/3-ën, duke e dënuar përfundimisht të pandehurën M.M me 8 vjet burgim, ndërsa të pandehurin F.M. me 6 vjet e 8 muaj burgim. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim nga të pandehurit, të cilët kanë kërkuar pafajësi, ndërsa e pandehura M.M., në alternativë, ka kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit me burgim sipas nenit 59 të KP-së.

4. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.574, datë 18.10.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke deklaruar: (i) të pafajshëm të pandehurin F.M. për veprën penale për të cilën akuzohej, atë të “Mashtrimi”, në bashkëpunim dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143, paragrafi 2, i KP-së; (ii) fajtorë të pandehurën M.M. për veprën penale “Mashtrimi” me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143, paragrafi 3, i KP-së (sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 36/2017, datë 30.03.2017) dhe dënuar atë me 6 vjet burgim. Pas aplikimit të uljes së dënimit, sipas nenit 406 të KPP-së, e pandehura është dënuar përfundimisht me 4 vjet burgim, dënim për pjesën e pavuajtur të të cilit është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit me kusht që për një periudhë kohe prej 4 vjetësh të mos kryente veprë tjetër penale dhe të mbante kontakte me shërbimin e provës. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs prokuroria e apelit dhe kërkuesja, të cilët kanë kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke ngritur pretendime në drejtim të pafajësisë së të pandehurit F.M. dhe pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurën M.M.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-55, datë 19.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të prokurorisë së apelit dhe të rekursit të kërkueses. Në lidhje me rekursin e prokurorisë së apelit, për sa u përket pretendimeve për pafajësinë e të gjykuarit F.M., ai kolegji ka arsyetuar se shkaqet e ngritura në të nuk u referoheshin atyre të parashikuar në nenin 432 të KPP-së, ndërsa ato kishin të bënin me mënyrën e vlerësimit të fakteve dhe provave, çka dilte jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Për sa u përket pretendimeve të prokurorisë për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të

gjykuarën M.M., ai kolegji ka konstatuar se në kohën e shqyrtimit të çështjes prej tij, e gjykuara e kishte shlyer periudhën e provës së caktuar me vendimin e gjykatës së apelit, ndaj vendimi i kësaj të fundit nuk duhej të cenohej duke u bazuar edhe në vendimin nr. 24, datë 27.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

6. Në lidhje me rekursin e kërkuases, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se ajo, në cilësinë e viktimës së veprës penale, nuk legjitimohet të ushtrojë recurs kundër vendimit përfundimtar të gjykatës së apelit. Sipas atij kolegji, referuar nenit 58 të KPP-së, ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, viktima e veprës penale ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin penal dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen, por nuk ka të drejtë ankimi/recursi kundër vendimmarrjes përfundimtare të gjykatës kur çështja penale është dërguar për gjykim me një akuzë konkrete, siç është dhe rasti në shqyrtim në të cilin vepra penale objekt procedimi penal është nga ato vepra që ndiqen kryesisht nga organi i akuzës, i cili mbron akuzën në gjykim dhe njëkohësisht ka edhe të drejtën ligjore të viktimës nga vepra penale. Po sipas atij kolegji, referuar edhe nenit 425, pika 2, të KPP-së, të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës, përveç të pandehurit, ligji ia ka njohur prokurorit dhe viktimës akuzuese, ndërsa kjo e fundit është subjekti i përcaktuar në nenin 59 të KPP-së, pra i dëmtuari nga ato vepra penale të cilat ndiqen me kërkesën e tij drejtpërdrejtë në gjykatë. Ai kolegji ka vërejtur se pretendimet në recurs të kërkuases janë në thelb të njëjta me ato të rekursit të prokurorisë së apelit, të cilat janë shqyrtuan prej tij.

7. Në datën 03.06.2024 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### Pretendimet e kërkuases

---

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

8.1 *Së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e ankimit*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, me arsyetimin se nuk legjitimohet të ushtrojë rekurs kundër vendimit përfundimtar të gjykatës së apelit. Në këtë mënyrë, ajo gjykatë nuk i ka shqyrtuar pretendimet, duke mos marrë kështu kërkuesja përgjigje përfundimtare për pretendimet e saj, në cenim të së drejtës së aksesit për të marrë pjesë në procesin penal, në të cilin ka statusin e viktimës. Kjo e drejtë i është cenuar kërkueses edhe nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa nuk ka qenë prezent në fillim të seancës, përveçse i është mohuar e drejta për të marrë informacion për statusin e procedimit, për t'u njohur me aktet dhe provat e çështjes, për të kërkuar marrjen e provave dhe për të paraqitur kërkesa të tjera procedurale, për t'u informuar për arrestimin dhe lirimimin e të akuzuarit, sikurse parashikon neni 58 i KPP-së, pas ndryshimeve të bëra në vitin 2017.

8.2 *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk ka arsyetuar asnjë prej pretendimeve të ngritura në rekursin e kërkueses, duke mos i dhënë kështu përgjigje asnjërit prej tyre. Vendimi është kontradiktor, sepse, nga njëra anë, nuk e legjitimon kërkuesen për shkaqet e rekursit, kurse, nga ana tjetër, në paragrafin 33 të vendimit, shprehet se pretendimet e saj lidhen me vlerësimin e fakteve dhe provave, por pa i analizuar ato.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. *Për legjitimimin e kërkueses*

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të

drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

10. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj se kërkuesi duhet të provojë legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se kërkuesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor që ka vendosur për fajësinë dhe pafajësinë e dy shtetasve, në lidhje me akuzën publike të ngritur ndaj tyre nga organi i prokurorisë për veprën penale “Mashtrimi”, në bashkëpunim dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143, pika 2, i KP-së (sipas ligjit të kohës së kryerjes së veprës), me pretendimin se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e ankimit dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

12. Duke marrë shkas nga pretendimet e ngritura nga kërkuesja, Kolegji çmon të evidentojë fillimisht se neni 148, pika 1, i Kushtetutës parashikon: “*Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit*.”. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se nga përmbajtja e kësaj dispozite rrjedh se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit dhe se për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar ngritjen e një organi të posaçëm për ushtrimin e ndjekjes penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Ajo ka theksuar se organi i prokurorisë ka si funksion kryesor ushtrimin e ndjekjes penale në emër të shtetit dhe përfaqësimin e akuzës publike në gjyq dhe se, përveç asaj, asnjë organ tjetër nuk është

i autorizuar për ushtrimin e këtyre funksioneve. Po kështu, Gjykata ka theksuar se një nga funksionet kryesore të shtetit të së drejtës është respektimi i kuadrit normativ nëpërmjet sigurimit të një drejtësie penale funksionale dhe se ndjekja penale që zhvillohet mbi bazën e akuzës publike duhet të jetë e mbështetur në dispozita ligjore të përcaktuara saktë (*shih vendimin nr. 3, datë 06.02.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Po kështu, Kolegji çmon të evidentojë se edhe ligji procedural penal ka parashikuar dhe subjektet e procesit penal, ndër të tjera, edhe atë të viktimës së veprës penale (neni 58 i KPP-së). Në kuadër të ndryshimeve që KPP-ja ka pësuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, pozita e viktimës së veprës penale ka pësuar ndryshime në drejtim të zgjerimit të së drejtës së aksesit, duke parashikuar shprehimisht për atë një sërë të drejtash procedurale, qoftë në fazën e hetimit paraprak, ashtu dhe në gjykimin e çështjes penale. Ashtu sikundër ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, referuar ligjit procedural penal, pavarësisht se viktima e veprës penale është pjesëmarrëse në procesin penal, pozita e saj nuk paraqitet e njëjtë me atë të prokurorit ose të të pandehurit, që krahas gjykatës, janë subjektet kryesore në një proces penal që mund të fillojë edhe kryesisht për ato vepra penale që mbartin në vetvete rrezikshmëri jo të vogël, nisur kjo nga interesi i lartë publik në ushtrimin e ndjekjes penale në këto raste dhe, sipas rastit, dënimi i autorit të veprës me pasoja jo të vogla ose në një masë të atillë që rrezikojnë të drejta kushtetuese të viktimës, siç mund të jenë ajo e shëndetit, pasurisë ose jetës. Në këto raste, interesi privat i viktimës së veprës penale përthithet nga interesi publik, ndaj përfaqësimi i akuzës publike në gjyq është përcaktuar nga ligjvënësi si tagër vetëm e organit të prokurorisë, duke i njohur atij dhe të drejtën e ankimit në gjykatat më të larta kundër një vendimi gjyqësor që ka vendosur në themel për fajësinë ose pafajësinë e një personi të akuzuar, të drejtë të cilën nuk ia ka njohur viktimës nga vepra penale.

14. Nga sa më lart, Kolegji vëren se kërkuesja nuk ka argumentuar dhe provuar cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të interesit të saj nga vendimi objekt kundërshtimi i kësaj kërkesë. Nisur nga kjo, si dhe duke mbajtur parasysh se ligji, për shkak të interesit publik, të drejtën për ngritjen e pretendimeve në drejtim të procesit të rregullt në proceset gjyqësore të themelit ia ka njohur organit të prokurorisë dhe jo viktimës së veprës penale, Kolegji vlerëson se kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae* për pretendimet e ngritura në lidhje me procesin gjyqësor dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë.

15. Për më tepër, në ankimin e saj, kërkuesja ka ngritur pretendime në lidhje me të drejtën e aksesit edhe ndaj procesit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, pavarësisht se në objekt nuk ka ndonjë pretendim për vendimmarrjen e saj. Në pretendimet e ngritura nga ajo, Kolegji vëren se vetëm njëri prej tyre i adresohet në fakt veprimtarisë së asaj gjykate, pikërisht ai në lidhje me të drejtën e viktimës së veprës penale për t'u thirrur në seancën e parë gjyqësore, ndërsa kërkuesja pretendon se nuk ka qenë prezent në fillim të seancës. Kolegji konstaton se, sikurse nuk kundërshtohet as nga kërkuesja, kjo e drejtë e viktimës së veprës penale, sikundër edhe të drejtat e tjera të pretenduara si të cenuara, janë njohur nga neni 58, pika 1, shkronja "h", i KPP-së, pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 01.08.2017, ndërkohë që procesi gjyqësor në shkallë të parë është realizuar dhe përmbyllur përpara kësaj date, pikërisht në datën 30.03.2017. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae* edhe për pretendimet e ngritura në lidhje me procesin gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë.

16. Në kushtet kur një nga kriteret paraprake nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë për shqyrtimin e kërkesës bëhet e panevojshme për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.